



Udhëzime për përdorimin e aplikacionit COBISS Lib

Manual për përdoruesit



United Nations
Educational, Scientific and
Cultural Organization

Regional Centre for
Library Information Systems and
Current Research Information Systems
Regionalni center za knjižnične
informacijske sisteme in informacijske
sisteme o raziskovalni dejavnosti



Përmbajtje

Përmbajtje	2
Udhëzime për përdorimin e aplikacionit COBISS Lib	3
1 Hyrje	4
1.1 Hyrja në COBISS Lib	4
1.2 Instalimi i shërbimit COBISS DGW	4
1.3 Instalimi i shërbimit signoPAD-API/Web për nevojat e përdorimit të tabelës për nënshkrim	5
1.4 Veprimet me skedarët	5
2 Ndërfaqja e përdoruesit COBISS Lib	6
2.1 Dritarja kryesore COBISS Lib	6
2.2 Dritarja për kërkim	6
2.3 Redaktuesi	7
2.4 Kontrolluesi	7
2.5 Moduli Raportet	8
2.6 Historia	9
2.7 Shkurtoret	9
3 Dritaret e projektuara në mënyrë të veçantë	10
3.1 Dritarja Kartela	10
3.2 Eksporti i të dhënave	10
3.3 Dritarja për kërkim Fondi për huazim	11
3.4 Dritarja Kalendari në modelin e botimit	11
4 Moduli Parametrat dhe administrimi	13
4.1 Përcaktimi i butonave të shpejtë për ekzekutimin e procedurave	13
5 Këshilla për përdorimin e COBISS Lib	14
6 Fillimi i punës në COBISS Lib	15
7 Lista e funksioneve që nuk mbështet COBISS Lib	16

Udhëzime për përdorimin e aplikacionit COBISS Lib

1 Hyrje

Gjenerata e re e programit, COBISS Lib, është aplikacion online me funksione të njëjta sikurse COBISS3, por me ndërfaqe të re të përdoruesit. Aplikacioni vepron në shfletuesit e zakonshëm të internetit dhe mund të përdoret në pajisje të ndryshme (edhe në tabletë dhe telefona mobil).

COBISS Lib, V13.0, mbështet funksionet e njëjta me aplikacionet lokale të COBISS3, por në versionin V13.0 [disa funksione ende nuk implementohen](#).

⚠ Përdorimi i COBISS3 dhe COBISS Lib njëherësh

Për një periudhë kohore do të mund të përdorni edhe COBISS3 edhe COBISS Lib, çfarë do të thotë se të gjitha ndryshimet e bëra në COBISS3 pasqyrohen edhe në COBISS Lib dhe anasjelltas.

Me emrin e njëjtë të përdoruesit mund të lidheni ose me COBISS3 ose me COBISS Lib, çfarë do të thotë se me të njëjtin emër përdoruesi nuk mund të punoni njëherësh në të dyja aplikacionet.

Në vazhdim të udhëzimeve janë paraqitur:

- [Hyrja në COBISS Lib](#)
 - instalimi i shërbimit COBISS DGW
 - instalimi i shërbimit signoPAD-API/Web
- [Ndërfaqja e përdoruesit COBISS Lib](#)
 - dritarja kryesore COBISS Lib
 - dritarja për kërkim
 - redaktuesi
 - kontrolluesi
 - moduli Raportet
 - historia
 - shkurtoret
- Dritaret e projektuara në mënyrë të veçantë
 - dritarja **Kartela**
 - eksporti i të dhënave
 - dritarja për kërkim **Fondi për huazim**
 - dritarja **Kalendari në modelin e botimit**
- Moduli **Parametrat dhe administrimi**
 - përcaktimi i butonave të shpejtë për ekzekutimin e procedurave
- Këshilla për përdorimin e COBISS Lib
- Fillimi i punës në COBISS Lib

1.1 Hyrja në COBISS Lib

COBISS Lib është aplikacion online. Për përdorimin e tij nevojitet një lidhje e qëndrueshme interneti dhe një prej shfletuesve të internetit (p.sh. Chrome, Firefox, Edge...).

Në aplikacionin COBISS Lib hyni përmes faqja elektronike <https://al.cobiss.net/bibliotekaret.htm>. Tek **COBISS Lib** përzgjidhni mundësinë **Hyrja në bazat reale**, shënoni akronimin ose emrin e bibliotekës dhe më pas nga lista përzgjidhni bibliotekën tuaj.

Në COBISS Lib mund të hyni edhe përmes adresës elektronike <https://cs.cobiss.net/clib/akronim/>, ku shënoni akronimin e bibliotekës suaj - p.sh. për bibliotekën e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë me akronimin BASH adresa elektronike është <https://cs.cobiss.net/clib/bash/>.

Pasi të klikoni në link do të shfaqet dritarja për lidhje COBISS Lib, në të cilën shënoni emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin, që janë të njëjtë me atë në COBISS3:

Dritarja për lidhje COBISS Lib

Autorizimet për punë në COBISS Lib janë të njëjta sikurse në COBISS3.

💡 Këshillë

Adresën për lidhje me aplikacionin COBISS Lib ruane midis linqeve të parapëlqyera apo në desktop, në mënyrë që të jetë më shpejt i disponueshëm.

⚠ Paralajmërime

Autorizimi për pop-ups në COBISS Lib : për aplikimin e të gjitha procedurave në aplikacionin COBISS Lib (p.sh. përgatitjen e raporteve) në shfletues duhet patjetër të mundësoni pop-ups për adresën elektronike të aplikacionit COBISS Lib.

Koha e pasivitetit në COBISS Lib dhe mbyllja automatike : pas një ore pasiviteti në COBISS Lib aplikacioni mbyllet në mënyrë automatike.

1.2 Instalimi i shërbimit COBISS DGW

Për përdorimin e pajisjeve periferike siç janë: printerët, pllakat RFID, arka etj., biblioteka duhet të instaloj shërbimin COBISS DGW. Ky shërbim mundëson komunikimin midis aplikacionit COBISS Lib dhe pajisjeve periferike.

Në tabelën poshtë është dhënë një pasqyrë e pajisjeve dhe shërbimeve, të cilat i përdor biblioteka apo ua ofron përdoruesve. Për secilën nga pajisjet në kolonën **SHËRBIMI COBISS DGW** është shënuar nëse instalimi i saj është i domosdoshëm apo jo.

SHËRBIMI/PAJISJA E BIBLIOTEKËS	SHËRBIMI COBISS DGW	PARAMETRI NË COBISS DGW	SHËNIMI
--------------------------------	---------------------	-------------------------	---------

SHËRBIMI/PAJISJA E BIBLIOTEKËS	SHËRBIMI COBISS DGW	PARAMETRI NË COBISS DGW	SHËNIMI
Printerët (etiketat, raportet, evidencat e huazimit/faturat)	PO	/	Printimi i evidencave të huazimit, faturave, etiketave, raporteve...
Lexuesit e barkodeve	JO		
Konfirmimi tatimor i faturave	PO	Edit TaxSI	Në COBISS DGW instaloni certifikatin për zyrën tatimore.
Shlyerja e borxhit me para në dorë jashtë bibliotekës	JO		
Pajisjet RFID - materiali	PO	Manage Local Devices (RFID_book)	
Pajisjet RFID - kartat e anëtarësisë	PO	Manage Local Devices (RFID_card)	
RFID - inventarizimi IZUM	PO	Manage Local Devices (RFID_book)	
Arka	DA		
Tabela për nënshkrim	JO		Instalimi i shërbimit online signoPAD API.
Dyert e sigurisë	JO		
Libromatët	JO		
Paketomatët	JO		
Printimi i të gjitha raporteve nga formati .PDF	JO		
VALÛ	PO	Edit Valu	
POS terminali			Për momentin nuk është i mundur përdorimi i integruar i POS terminalit, mirëpo mund të përdoret përmes shënimit të shumës në POS terminal.
Urbana			Ende nuk aplikohet.

Procedura e instalimit të shërbimit COBISS DGW dhe rregullimi i parametrevë janë përshkruar në udhëzimet [Instalimi dhe rregullimi i shërbimit COBISS DGW](#).

Paralajmërimë

Për instalimin e shërbimit në kompjuter ju duhen autorizimet e administratorit. Për rregullimin e parametrevë të veçantë në COBISS DGW nuk keni nevojë për këto autorizime.

Shërbimi COBISS DGW është në dispozicion vetëm për sistemin operativ Microsoft Windows. COBISS DGW nuk mund të instalohet në pajisjet mobile, për këtë arsye nga këto pajisje nuk mund të printoni, t'i shlyeni borxhet...

Nëse përdorni printerë në rrjet ose server për printim, për të hyrë në *Cobiss3JettyService* duhet të përdorni emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin e domenit. Këtë mund ta rregulloni në kuadër të instalimit të shërbimit COBISS DGW sipas udhëzimeve [Instalimi dhe rregullimi i shërbimit COBISS DGW](#).

Instalimi i shërbimit COBISS DGW është i detyrueshëm, ndërsa brenda këtij shërbimi edhe instalimi i certifikatit nga dosja *C:\Cobiss3Files\cert*, nëse biblioteka është përgjegjëse për vërtetimin tatimor të faturave dhe dëshiron të aplikoj shlyerjen e borxheve në COBISS Lib. Procedura është përshkruar në udhëzimet [Instalimi dhe rregullimi i shërbimit COBISS DGW](#).

Nëse dëshironi të ndryshoni parametrat në shërbimin COBISS DGW (p.sh. të instaloni certifikatin për vërtetimin tatimor të faturave), aplikacionin COBISS Lib duhet ta mbyllni dhe ta hapni sërish.

1.3 Instalimi i shërbimit signoPAD-API/Web për nevojat e përdorimit të tabelës për nënshkrim

Për përdorimin e tabelës për nënshkrim në aplikacionin COBISS Lib duhet të instaloni shërbimin signotec signoPAD-API/Web. Përshkrimi i shërbimit dhe udhëzimet për instalim ndodhen në linkun <https://en.signotec.com/software/integration-sdk-api-/signopad-api-web/>. Skedarin e instaluar e gjeni në fund të faqes në rubrikën *Links*, ku përzgjidhni mundësinë *Download signoPAD-API/Web (V. 3.3.1)*.

Në dritaren për instalim wizard, e cila hapet sapo të filloni instalimin, në rubrikën *URL* përzgjidhni mundësinë *localhost and 127.0.0.1*.

Paralajmërimë

Për instalimin e shërbimit në hapësirën e punës janë të nevojshme autorizimet e administratorit.

Përdorimi i tabelës për nënshkrim mbështetet nga sistemi operativ Microsoft Windows.

1.4 Veprimet me skedarët

Veprimet me skedarët në aplikacionin COBISS Lib bëhen në përputhje me funksionalitetin e shfletuesve në internet. Nëse për ekzekutimin e një procedure është i nevojshëm skedari (p.sh. **Përditëso të dhënat për anëtarët – eksporti**), në dritaren **Përzgjedhja e skedarit** përmes butonit **Përzgjidh skedarin...** gjeni atë apo tërhiqeni nga vendi ku është ruajtur dhe kopjojeni në kornizën përkatëse.

Mundësia për të përcaktuar ose ndryshuar vendndodhjen për ruajtjen e skedarit dhe për shënimin e emrit të skedarit të transferuar tek procedurat për krijimin e skedarëve (p.sh. **Përditëso të dhënat për anëtarët – eksporti** apo me mundësinë **Eksporto në skedarin tekst** në dritaret për kërkim), varet nga parametrat e shfletuesit të internetit. Vendi i paracaktuar për ruajtjen e skedarëve më së shpeshti është dosja *Downloads*, ndërsa skedari zakonisht e ruan emrin që e ka ofruar vetë aplikacioni gjatë procedurës së shkarkimit.

Rregullimi i parametrevë të shfletuesit në mënyrë që përdoruesi gjatë transferimit përzgjedh vendndodhjen dhe shënon emrin e skedarit

Midis parametrevë të shfletuesit të internetit gjeni mundësinë *Downloads* dhe më pas përzgjidhni funksionet **Para transferimit më pyet për vendin ku dëshiroj ta ruaj secilin skedar** apo **Always ask you where to save files**.

Paralajmërim

Ju rekomandojmë që të keni kujdes tek procedurat ku përdoren skedarët, sepse shpesh bëhet fjalë për procedurat e ndryshimit të shumicës së të dhënave.

2 Ndërfaqja e përdoruesit COBISS Lib

Ndërfaqja e përdoruesit COBISS Lib përbëhet nga këto komponentë:

- dritarja kryesore COBISS Lib
- dritarja për kërkim
- redaktuesi
- kontrolluesi

2.1 Dritarja kryesore COBISS Lib

Dritarja kryesore COBISS Lib mundëson këto funksione:

The screenshot shows the COBISS Lib main interface. At the top, there is a header with the logo and navigation icons. Below the header, there is a sidebar with various menu items. The main content area is divided into several sections, each with a numbered callout:

- 1: Dritare aktive për kërkim
- 2: BQJ / 01 Sektori për fëmijë
- 3: KATA
- 4: ANET
- 5: KTHE
- 6: REZE
- 7: Pasurimi
- 8: Serialet
- 9: Burimet elektronike
- 10: Koleksionet e bibliotekës
- 11: Huazimi
- 12: Huazimi ndërbibliotekar
- 13: Parametrat dhe administrimi
- 14: Raportet
- 15: Materiali
- 16: Fusha 998
- 17: Fusha 996/997

Dritarja kryesore e aplikacionit COBISS Lib

1. Aktivizimin e ekranit të plotë
2. Informacionet për bazën dhe departamentin tuaj
3. Përzgjedhjen e departamentit dhe kalimin nga njëri departament tek tjetri
4. Historinë e regjistrimeve
5. Regjistrimet e parapëlqyera
6. Pasqyrën e njoftimeve dhe numrin e tyre
7. Përpunimin e rezervimeve dhe numrin e rezervimeve të arritura
8. Monitorimin e kërkesave për huazim ndërbibliotekar (HN) me numrin e kërkesave të arritura
9. Ndihmën dhe informacionet për aplikacionin COBISS Lib
10. Informacionet për përdoruesin dhe mundësinë për shkëputje nga aplikacioni COBISS Lib
11. Emrin e grupit të përbajtjes me ikonën përkatëse që përcakton grupin
12. Mundësinë për shtimin e regjistrimit të ri në grupin e përzgjedhur të përbajtjes
13. Hapjen e dritares për kërkim për grupin e përzgjedhur të përbajtjes duke klikuar në emrin e grupit
14. Procedurat në grupin e përbajtjes; procedurat e veçanta të aktivizimit duke klikuar në emrin e procedurës
15. Dritaren me modulet e aplikacionit COBISS Lib; shfaqjen vetëm ato module për të cilat posedoni lejen
16. Mundësinë e aktivizimit të dritareve aktive për kërkim
17. Butonat me shkurtoret për ekzekutimin e procedurave

2.2 Dritarja për kërkim

Në dritaren për kërkim COBISS Lib paraqiten së bashku elementet e dritares për kërkim dhe hapësira e punës. Lista e regjistrimeve të gjetura prezanton hapësirën e punës për grupin e përzgjedhur të përbajtjes dhe mundëson ekzekutimin e procedurave që aplikohen me regjistrimet e përzgjedhura në atë grup.

Pjesët dhe funksionet e dritares për kërkim janë:

The screenshot shows the COBISS Lib search interface. At the top, there is a header with the logo and navigation icons. Below the header, there is a sidebar with various menu items. The main content area is divided into several sections, each with a numbered callout:

- 1: Paneli i kontrollit
- 2: Anëtarit
- 3: Fusha 996/997
- 4: Regjistrimi bibliografik
- 5: Porosia
- 6: Numri i inventarit (f) ose kërkimin e specializuar ose fjalët kyçe
- 7: COBISS-KS-ID
- 8: Nivendendodhja (dji)
- 9: LP: Libri për fëmijë
- 10: Data e inventarit (o)
- 11: Nga:
- 12: Deri:
- 13: Klasifikim:
- 14: Paracaktuar
- 15: Pyetësorit e mi
- 16: Numri i gjetjeve: 27 260
- 17: Treguesi L...

Dritarja për kërkim në grupin e përbajtjes **Fusha 996/997** në aplikacionin COBISS Lib

1. Skedat me emrin e grupit të përbajtjes, në të cilin keni kërkuar së fundmi në COBISS Lib (në figurë është aktive dritarja për kërkim e grupit të përbajtjes **Fusha 996/997**)
2. Fusha për kërkimin përmes çelësit (p.sh. me numrat e inventarit në dritaren për kërkim **Fusha 996/997**), fjalëve kyçe ose kërkimin e specializuar
3. Kërkimi i specializuar është i mundur në grupet e përbajtjes **Materiali**, **Fusha 996/997** dhe **Regjistrimi bibliografik**.
4. Butoni për shfaqjen e listës së parashtesave dhe prapashtesave për kërkim, si dhe përshkrimin e mundësisë për kufizim dhe skanim
5. Lista me emrin e grupit të përbajtjes, nëse në dritaren për kërkim mundësohet kërkimi në disa grupe njëherësh
6. Lista për përzgjedhjen e fushave për kërkim
7. Lista për përzgjedhjen e operatorëve EMPTY, NOT ose NOTEMPTY
8. Fushat për shënimin e pyetjes për kërkim
9. Butoni për kërkim; nëse nuk shënoni pyetjen për kërkim, duke klikuar në këtë buton gjëni të gjitha regjistrimet në grupin e përzgjedhur
10. Butoni për pasqyrën e termave
11. Butoni për largimin e fushës për kërkim

11. Butoni për shtimin e pyetjes për kërkim
12. Butoni për fshirjen e pyetjes për kërkim
13. Butoni për përsëritjen e kërkimit të fundit
14. Lista për përzgjedhjen e të dhënave sipas të cilave do të klasifikohen rezultatet e kërkimit; mund të përcaktoni rendin ngritës ose zbritës të klasifikimit
15. Lista për përzgjedhjen e pyetësorëve të ruajtur
16. Butoni për redaktimin e pyetësorëve të ruajtur
17. Butoni për ruajtjen e pyetësorëve
18. Butoni për përcaktimin dhe përzgjedhjen e formatit të rezultateve të kërkimit
19. Butoni për shtimin e regjistrimeve tek shkurtoret
20. Butoni për ngarkimin e 100 regjistrimeve të tjera (fillimisht shfaqen vetëm 20 regjistrimet e para)
21. Butoni për hapjen e **kontrolluesit të regjistrimit**, ku fillimisht duhet të përzgjidhni një ose disa regjistrime nga lista e rezultateve të kërkimit
22. Butoni për hapjen e **redaktuesit të regjistrimit**, ku fillimisht duhet të përzgjidhni një regjistrim nga lista e rezultateve të kërkimit
23. Butoni për mundësitë shtesë: eksporti në skedarin e formatit .txt, printimi, dërgimi në destinacion, shtimi në radhën e raportit dhe ngarkimi i sërishëm i regjistrimeve nga baza e të dhënave (freskimi). Për shfaqjen e butonit duhet të përzgjidhni një ose disa regjistrime nga lista e rezultateve të kërkimit
24. Kutia për përzgjedhjen e regjistrimit nga lista e rezultateve të kërkimit
25. Kutia për përzgjedhjen/anulimin e përzgjedhjes së regjistrimeve nga lista e rezultateve të kërkimit
26. Shfaqja e numrit të regjistrimeve të gjetura
27. Butonat për ekzekutimin e procedurave
28. Mundësia e shfaqjes së dritareve aktive apo të hapura për kërkim

Nëse në grupin e përmbajtjes është aktive procedura për shtimin e regjistrimit të ri, para butonit **Redakto** shfaqet edhe butoni **Shto**. Në dritaren për kërkim të grupit të përmbajtjes **Materia** është në dispozicion edhe butoni **Shkarko regjistrimin** për shkarkimin e regjistrimit nga baza e përbashkët e të dhënave.

🔍 Përzgjedhja e disa regjistrimeve njëherësh

Nëse dëshironi që të përzgjidhni disa regjistrime njëherësh (p.sh. regjistrimet nga numri rendor 8 deri 15), fillimisht shtypni tastin **<Ctrl>**, më pas klikoni në numrin rendor (jashtë kutisë së zgjedhjes) të regjistrimit të parë që dëshironi të filloni përzgjedhjen, pastaj shtypni dhe mbanini të shtypur tastin **<Shift>** dhe klikoni numrin rendor të regjistrimit të fundit që dëshironi të përzgjidhni.

⚠️ Ngarkimi i regjistrimeve në dritaren për kërkim

Regjistrimi i ri apo regjistrimi, me të cilin keni aplikuar procedura të ndryshme, ngarkohet lart në fillim të listës së rezultateve të kërkimit. Në të njëjtën kohë regjistrimi i shtuar përzgjidhet, ndërsa programi ju dërgon tek ky regjistrim në mënyrë automatike.

2.3 Redaktuesi

Pjesët dhe funksionet e redaktuesit janë:

Redaktuesi i të dhënave për anëtarin

1. Shiriti i titullit të redaktuesit me emrin e grupit të përmbajtjes
2. Skedat e redaktuesit
3. Emërtimi i të dhënave; të dhënat e detyrueshme janë të shënuara me yll *
4. Vlera, të cilën e shënoni në fushë, e përzgjidhni nga lista, e përzgjidhni përmes kutisë për zgjedhje etj.
5. Mundësia për krijimin, kontrollimin dhe fshirjen e lidhjeve të këtij regjistrimi me regjistrimet e tjera
6. Regjistrimet, të cilat mund të shtohen, redaktohen, fshihen dhe kontrollohen
7. Butonat për ekzekutimin e procedurave në regjistrimin e përzgjedhur
8. Butoni **Në rregull** mundëson ruajtjen e regjistrimit
9. Butoni **Anulo** mundëson mbylljen e redaktuesit pa i ruajtur ndryshimet e bëra në regjistrim

2.4 Kontrolluesi

Kontrolluesi COBISS Lib mundëson kontrollimin e regjistrimeve dhe ngarkimin e regjistrimeve të përzgjedhura në dritaret aktive për kërkim, tek shkurtoret ose në histori.

Pjesët dhe funksionet e kontrolluesit janë:

Kontrollimi - Materiali: nr. rendor 4

← → ↑ ↓

Formati bazë COMARC

Emri i atributit	Vlera
COBISS.KS-ID:	119325
Titulli:	Në hap me kohën
Autori:	Below, Saul
Gjuha:	alb - shqipe
Botimi:	
Viti i botimit:	1989
Shënim:	
Shën. në formularë:	
Vendi i botuesit:	Prishtinë
Botuesi:	Rilindja
Nr. i botuesit (muzikë e shtypur):	
Niveli bibliografik:	monografi
Përshkrimi fizik:	

Regjistrimi bibliografik: Në hap me kohën / Soll Below ; [përkthen Avni Spahiu]. - 1989

Fushat 996/997 (6)

FU	996; IN=100000268; SG=ILRR\w821.111(73)\aBELOW S.\\$Në hap me kohën
FU	996; IN=100000320; SG=ILRR\w821.111(73)\aBELOW S.\\$Në hap...
FU	996; IN=100000388; SG=ILRR\w821.111(73)\aBELOW S.\\$Në hap me kohën
FU	996; IN=100000389; SG=ILRR\w821.111(73)\aBELOW S.\\$Në hap me kohën

Përzgjidh Shfaq Shto në shkurtores Në histori Mbyll

Kontrolluesi i regjistrimit të përzgjedhur

- Shiriti i titullit me emrin e grupit të përmbajtjes
- Butoni për lëvizje nëpër regjistrime: **Prapa**, **Përpara**, **I mëparshmi** dhe **Tjetri**
- Shfaqja e të dhënave për regjistrimin e përzgjedhur
- Regjistrimi në lidhshmëri
- Butoni **Përzgjidh**, i cili ngarkon regjistrimin e përzgjedhur në dritaren aktive për kërkim
- Butoni **Shfaq**, i cili hap kontrolluesin për regjistrimin e përzgjedhur në lidhshmëri
- Butoni **Shto në shkurtores**, i cili shton regjistrimin e përzgjedhur në shkurtores
- Butoni **Në histori**, i cili shton regjistrimin e përzgjedhur në histori

Në dritaret aktive për kërkim mund të ngarkohen njëherësh vetëm regjistrimet nga grupi i njëjtë i përmbajtjes. Nëse tek regjistrimet në lidhshmëri në vend të regjistrimit të caktuar përzgjidhni emrin e grupit të përmbajtjes dhe më pas klikoni butonin **Përzgjidh**, hapet dritarja e re me tabelën e regjistrimeve në grupin në lidhshmëri të përmbajtjes. Mundësitë në këtë dritare janë të njëjta me ato të cilat ofron **dritarja për kërkim** tek pjesa e rezultateve të kërkimit.

2.5 Moduli Raportet

Moduli **Raportet** ndodhet në të njëjtin nivel me modulet e tjera në aplikacionin COBISS Lib.

Në dritaren kryesore të këtij moduli mundësitë janë të paraqitura në skeda të veçanta.

Dritaret aktive për kërkim

Te preferuarat **Raportet** Ndryshoret Klasifikimet Eksporti i të dhënave

Pasurimi Serialet Burimet elektronike Koleksionet e bibliotekës Huazimi Huazimi ndërbibliotekar Parametrat dhe administrimi **Raportet**

Përkufizimet standarde Përkufizimet e përdoruesit

1 Katalogimi
 2 Pasurimi
 3 Serialet
 4 Burimet elektronike
 5 Koleksionet e bibliotekës

6 Huazimi
 8 Administrimi i aplikacioneve

Raportet: Listat

Përkufizimet e raportit

- KB-LIS-01: Libri i inventarit
- KB-LIS-01: Libri i inventarit (dritarja për kërkim)
- KB-LIS-01: Libri i inventarit (raporti pa titull)
- KB-LIS-01: Libri i inventarit (raporti pa titull) (dritarja për kërkim)
- KB-LIS-02: Lista e materialeve të çregjistruara
- KB-LIS-02: Lista e materialeve të çregjistruara (dritarja për kërkim)
- KB-LIS-03: Lista e serialeve (gjuha sllovene dhe gjuhët e tjera)
- KB-LIS-04: Lista e serialeve
- KB-LIS-05: Lista e serialeve sipas financuesve
- KB-LIS-06: Lista e serialeve sipas financuesve (gjuha sllovene dhe gjuhët e tjera)
- KB-LIS-07: Eksportimi i të dhënave në formatin MFERAC (aktuale)
- KB-LIS-07: Eksportimi i të dhënave në formatin MFERAC (retrospektive)
- KB-LIS-09: Eksporti i të dhënave në formatin Dublin Core
- KB-LIS-10: Lista e fushave 996/997 (formati i plotë)
- KB-LIS-11: Lista e fushave 008 (formati i plotë)

Fshi raportet e përgatitura Shfletto raportet e përgatitura Shto tek të preferuarat Përgatit raportin sipas orarit Përgatit raportin Mbyll

Raportet në aplikacionin COBISS Lib


Skadat ofrojnë këto mundësi:

- Raportet e parapëlqyera (skeda **Të parapëlqyerat**), ku mund të përzgjidhni midis raporteve tuaja të parapëlqyera dhe raporteve të parapëlqyera në nivel të bibliotekës
- Të gjitha raportet (skeda **Raportet**), ku mund të përzgjidhni midis përkufizimeve standarde dhe të përdoruesit
- Ndryshoret (skeda **Ndryshoret**), ku bëhet kontrollimi dhe redaktimi i ndryshoreve (përkufizimet standarde dhe të përdoruesit)
- Klasifikimet**, ku bëhet kontrollimi dhe redaktimi i klasifikimit; kjo mundësi ende nuk është në dispozicion.
- Eksporti i të dhënave**, që përvëç eksportit të të dhënave mundëson edhe kontrollimin e të dhënave të eksportuara. Për përdorimin e këtyre funksioneve nuk janë të nevojshme autorizimet për modulën **Raportet**.

Pasi të klikoni në emrin e grupit të veçantë të raporteve, ndryshoreve etj., hapet një dritare e re, ku mund të përzgjidhni procedurat, të cilat i mundëson funksioni i veçantë. P.sh. përzgjidhni raportin, IZUM, 2023-12-20

me të cilin dëshironi të kryeni ndonjë funksion (6), më pas procedurën e ekzekutoni duke klikuar butonin përkatës (7)(p.sh. butonin **Përgatit raportin** për përgatitjen e raportit).


2.6 Historia

Duke klikuar butonin  hapet dritarja **Historia**, e cila ofron pasqyrën e regjistrimeve me të cilat keni aplikuar procedura të ndryshme.

Numri i regjistrimeve në histori

Në histori ruhen më së shumti 500 regjistrime, të cilat i keni përdorur gjatë punës. Kur ky kufi të arrihet, regjistrimet nga historia fillojnë të fshihen në mënyrë automatike.

2.7 Shkurtoret

Regjistrimet nga grupet e ndryshme, të cilat i përdorni më shpesh gjatë punës, mund t'i shtoni midis shkurtoreve (regjistrimet e parapëlqyera). Deri tek këto regjistrime arrini nëse klikoni butonin . Regjistrimet në shkurtore i shtoni nga rezultatet e kërkimit ose nga kontrolluesi.

Kufizimi i numrit të shkurtoreve

Numri më i madh i lejuar i shkurtoreve të ruajtura është 100. Kur ky kufi të arrihet, nuk mund të shtoni regjistrime të tjera. Në këtë rast nga shkurtoret duhet të fshihen regjistrimet që nuk janë të nevojshme.

3 Dritaret e projektuara në mënyrë të veçantë

3.1 Dritarja Kartela

Në dritaren **Kartela** ekzekutohen procedura të evidentimit të materialit tek anëtarin dhe departamenti, por edhe mund të kalohet në redaktuesin e të dhënave për anëtarin dhe fondin lokal të materialeve të bibliotekës. Kjo dritare zëvendëson dritaren **Materiali i bibliotekës kryesore** në COBISS3.

Pjesët dhe funksionet e dritares Kartela janë:

The screenshot shows the 'Kartela' interface for user 'Antigona Balaj'. The main area displays a list of materials with columns for 'Nr.', 'Materiali', 'Të dhënat e tjera', 'Të dhënat për huazimin', and 'Vazhdimi'. Two materials are listed: 'Kapiten Tornado' and 'Mobi Dik'. The sidebar on the right shows user details, including 'Karta e anëtarësisë', 'Anëtarësia', 'Vizita', and 'Titujt'. A navigation bar at the bottom contains various menu items like 'Shënim i përkohshëm', 'Ndryshimi po vazhdon', and 'Kontrollo vazhdimet e afatit të kthimit'.

Dritarja Kartela - skeda Huazimi

1. Informacionet për anëtarin apo departamentin, për të cilin keni hapur evidencën e materialit
2. Butoni për të lëvizur nëpër departamentet e bibliotekës (në bibliotekën me departamente)
3. Mundësia e paraqitjes së materialeve të të gjitha departamenteve (në bibliotekën me departamente)
4. Lista për përzgjedhjen e procedurës që do të ekzekutohet me materialin (p.sh. huazimi, kthimi, rezervimi etj.)
5. Skedat e materialit të evidentuar tek anëtarin (sipas statusit të materialit); shfaqen vetëm skedat me statuse, për të cilat tek anëtarin është evidentuar materiali
6. Pjesa kryesore e dritares me të dhënat për materialin e evidentuar
7. Procedurat që mund t'i ekzekutohen për evidentimin e materialit (para kësaj përzgjedhni kopjen, tek e cila dëshironi të ekzekutoheni procedurën)
8. Butoni për përgatitjen dhe printimin apo dërgimin e evidencave të huazimit
9. Butonin për procedurat, të cilat mund t'i ekzekutohen për evidentimin e materialit bazuar në përzgjedhjen nga lista (p.sh. zgjatja e afatit të huazimit, huazimi i materialit të disponueshëm); procedurat ndryshojnë varësisht nga skeda e përzgjedhur
10. Lista për përzgjedhjen e formatit të shfaqjes së materialit të evidentuar (p.sh. të materialit të evidentuar në ditën aktuale)
11. Mundësia e përzgjedhjes së materialit, për të cilin dëshironi të ekzekutoheni procedurën
12. Të dhënat për anëtarin, prej nga mund të kaloni në redaktuesin e të dhënave për anëtarin ose të ekzekutoheni metodat e caktuara për anëtarin e përzgjedhur (p.sh. kontrollimi i transakcioneve të anëtarit)
13. Butoni për hapjen e katalogut të bibliotekës në COBISS+
14. Butoni për hapjen e dritares për kërkim në fondin e materialeve për huazim; materialin e gjetur mund ta huazoni, rezervoni etj.

Ekzekutimi i procedurave me materialet

Procedurat, të cilat mund t'i ekzekutohen me materialet, i përzgjidhni nga lista - shih nr. 4 në figurën lart.

Nëse klikoni në emrin e skedës së veçantë në listë aktivizohet procedura, të cilën mund ta ekzekutoheni në këtë skedë - p.sh. nëse klikoni në emrin e skedës **Huazimi** aktivizohet procedura **Huazimi jashtë bibliotekës**, nëse klikoni në emrin e skedës **Kthimi** aktivizohet procedura **Kthe/Fshi...**

3.2 Eksporti i të dhënave

Eksporti i të dhënave mund të bëhet përmes modulit **Raportet** në skedën **Eksporti i të dhënave**. Nga kjo skedë mund të hyni edhe në skedarët me të dhënat e eksportuara.

⚠ Eksporti i të dhënave

Për përdorimin e këtij funksioni nuk nevojitet autorizimi për modulën **Raportet**.

Dritarja kryesore **Eksporti i të dhënave** ka formën e dritares dyshe, ku në dritaren në të majtë përzgjidhni të dhënat, për të cilat dëshironi të ekzekutoheni eksportin, si dhe përzgjidhni mundësinë e përgatitjes së pyetësorëve ose filtrave. Pasi të klikoni në **Shto** ose **Shto të gjitha**, të dhënat që dëshironi t'i eksportoni kalojnë në dritaren në të djathtë.

Pjesët e dritares për eksportin e të dhënave janë këto:

Eksporti i të dhënave - Fusha 996/997

1. Fusha 996/997

- > Huazuar/rezervuar (Rezervimi i materialit)
- > Huazuar/rezervuar (Rezervimi i kopjes)
- > Huazuar/rezervuar (Huazim për sallë të leximit)
- > Huazuar/rezervuar (Huazimi jashtë bibliotekës)
- > Huazuar/rezervuar (Huazimi ndërmjet departamenteve)
- > Huazuar/rezervuar (Huazimi ndërbibliotekar)

Shto të gjitha > 4 Shto >
< Largo 5 < Largo të gjitha

Papërzgjedhur - Fusha 996/997

2. Fusha 996/997

ABC dhe shenja të tjera - pjesa 1 (d/a)

ABC dhe shenja të tjera - pjesa 2 (d/5)

COBISS.KS-ID

3. Data e statusit (t)

Data e çregjistrimit të vitit

Dublikata (d/d)

Financuesi (4)

Përzgjedhur

Autori (Fusha 996/997)

Data e inventariz. (o) (Fusha 996/997)

Nënvendndodhja (d/i) (Fusha 996/997)

6. Shënimet (n) (Fusha 996/997)

Statusi (q) (Fusha 996/997)

Titulli (Fusha 996/997)

Vendosur nga (Fusha 996/997)

Viti i botimit (Fusha 996/997)

7. C'mimi (r) (Fusha 996/997)

7. Eksportet
8. Gjej
9. Ruaj
Mbyll

Dritarja Eksporti i të dhënave

1. Grupi i përzgjedhur i përmbajtjes
2. Të dhënat e grupit të përmbajtjes (nëse klikoni mbi to i përzgjidhni për eksport)
3. Butoni për formimin e pyetësorit apo filtrit
4. Butoni për shtimin e të dhënave për eksport
5. Butoni për largimin e të dhënave nga eksporti
6. Të dhënat e përzgjedhura për eksport
7. Butoni për ekzekutimin e eksportit të të dhënave
8. Butoni për ekzekutimin e kërkimit
9. Butoni për ruajtjen e përkufizimit të eksportit të të dhënave

3.3 Dritarja për kërkim **Fondi për huazim**

Për kërkim në COBISS Lib përdoret katalogu i bibliotekës në COBISS+. Pas përzgjedhjes së procedurës **Katalogu** (p.sh. në dritaren **Kartela**) hapet katalogu në COBISS+ për bazën lokale, në të cili ndodheni. Në rast se biblioteka ka departamente hapet katalogu për departamentin, në cilin ndodheni në COBISS Lib.

Rezervimi i materialit

Nëse dëshironi të rezervoni materialin duke e përzgjedhur atë nga katalogu COBISS+, fillimisht kontrolloni të dhënat për koleksionet dhe nga to kopjoni numrin e inventarit të materialit që dëshironi ta rezervoni.

Për të kërkuar në fondin, të cilin biblioteka e ka në dispozicion për huazim, është mundësuar qasja në dritaren për kërkim nga dritarja **Kartela** e anëtarit ose e departamentit, përmes butonit **Fondi për huazim**. Kërkimi në fond bëhet në të njëjtën mënyrë sikurse kërkimi i materialit në **dritaren për kërkim Fusha 996/997**.

Midis kopjeve të gjetura të materialit mund të përzgjidhni një ose disa kopje dhe mund të ekzekutoni këto procedura:

- huazimin jashtë bibliotekës
- rezervimin
- huazimin në sallë të leximit
- rezervimin për sallë të leximit
- kontrollimin e gjendjes së kopjes së përzgjedhur

Kërkimi me ndihmën e shiritit të mençur

Në fushën e parë të dritares për kërkim **Fondi për huazim**, në fushën *Numri i inventarit (f) ose kërkimi i specializuar ose fjalët kyçe* mund të kërkoni në fondin e materialeve duke shënuar numrin e inventarit, autorin ose titullin e materialit.

Shënim

Në COBISS Lib, V13.0, është përfshirë versioni 1 i dritares për kërkim të fondit për huazim, për këtë arsye nuk janë në dispozicion të gjitha funksionet (p.sh. ruajtja e fushave të paracaktuara për kërkim, shfaqja e të dhënave për kompletin etj.). Përditësimet planifikohen të bëhen në versionet në vazhdim.

3.4 Dritarja **Kalendari në modelin e botimit**

Në COBISS Lib dritarja për redaktimin e datave të pranimit të njësive ndryshon nga dritarja **Kalendari i botimit** në COBISS3:

- kontrolli në kalendar është gjithmonë në nivelin ditor,
- njësitë e pritshme kanë ngjyrë të gjelbërt,
- njësitë e bashkuara kanë ngjyrë të verdhë,
- datat, kur njësitë nuk botohen, nuk janë të përzgjedhura,
- bashkimi i kopjeve në numra dysh e tresh bëhet vetëm tek kontrolli i ardhjeve dhe jo në kalendar,
- përcaktimi i kohës kur është botuar ose jo kopja është i mundur në datën e caktuar ose në një ditë në javë,
- mund të tregohet se njësia nuk botohet gjatë festave.

2023

Periodiciteti i b... Numri i parë i ... Modeli vlen de...

ditor 03.01.2023 31.12.2023

Është botuar Shto

Nuk është botuar Shto

Përzgjidh Java e muajit Dita e javës

Dita e javës secili E diele

Përzgjidh Data

Data 01.01.2024

Përzgjidh Data

Data 01.05.2023

Përzgjidh Data

Data 01.10.2023

Përzgjidh Data

Data 02.01.2024

Përzgjidh Data

Data 08.02.2023

Janar Shkurt Mars

Prill Maj Qershor

Korrik Gusht Shtator

4 to festat midis "Nuk është botuar" Në rregull Anulo

Dritarja Kalendari në modelin e botimit

Dritarja Kalendari në modelin e huazimit ofron këto mundësi:

1. Të dhënat për periodicitetin dhe periudhën e botimit
2. Të dhënat rreth botimit të njësisë, parasegjithash tek periodiciteti *nuk dihet, i papërcaktuar, tjetër*
3. Informacioni se njësisia nuk është botuar
4. Informacioni se njësisia nuk botohet gjatë festave

4 Moduli Parametrat dhe administrimi

Në modulën **Parametrat dhe administrimi** janë në dispozicion funksionet e modulit [COBISS3/Administrimi i aplikacioneve](#) dhe funksionet e tjera që në COBISS3 ndodhen tek [Sistemi](#).

Në këtë modul është në dispozicion edhe mundësia për [përcaktimin e butonave të shpejtë për ekzekutimin e procedurave](#).

⚠ Qasja në modulën Parametrat dhe administrimi

Qasja në modul është i mundur për të gjithë përdoruesit, mirëpo për ekzekutimin e procedurave të veçanta (p.sh. redaktimi i të dhënave për partnerët) nevojiten **autorizime të veçanta**.

Në modulën **Parametrat dhe administrimi** redaktohen parametrat për grupet e përmbajtjes në vazhdim:

- Biblioteka kryesore
- Partneri
- Të dhënat për kontakt
- Përdoruesi i sistemi
- Parametrat
- Pasqyra e përpunimit të të dhënave personale (LMDhP)
- Njoftimet
- Serveri

Është i mundur edhe kërkimi në bazën e të dhënave COLIB.

4.1 Përcaktimi i butonave të shpejtë për ekzekutimin e procedurave

Në COBISS Lib mund të përcaktoni dhe të aktivizoni butonat për qasje të shpejtë në ekzekutimin e procedurave të caktuara. Butonat, të cilët i shtoni dhe i emëroni vet, janë të lidhur me emrin e përdoruesit.

Procedura




1. Në grupin **Parametrat** përzgjidhni procedurën **Vendos shkurtoret për procedurat**. Hapet dritarja **Redaktuesi i shkurtoreve të procedurave**.
2. Pasi të klikoni në butonin **Shto** hapet dritarja për përcaktimin e butonave të shpejtë. Përmes miut përzgjidhni procedurat e veçanta, për të cilat dëshironi t'i përcaktoni shkurtoret. Për çdo shkurtores në anën e majtë të dritares, në rubrikën **Shenja e procedurës** shënoni emërtimin me më së shumti 4 karaktere të tastit për shkurtores, ndërsa tek **Aktiviteti** klikoni kutinë e zgjedhjes për të treguar nëse dëshironi ta aktivizoni shkurtores.
3. Parametrat i ruani duke klikuar në butonin **Në rregull**. Kthehuni në dritaren **Redaktuesi i shkurtoreve të procedurave**.
4. Pasi të klikoni butonin **Mbyll**, butoni me ikonën e përcaktuar paraprakisht dhe me emërtimin e shënuar do të shtohet nën shiritin e titullit të aplikacionit COBISS Lib.

Mund të redaktoni edhe renditjen e butonave ose t'i fshini ata. Këto mundësi janë në dispozicion në shiritin e komandave të dritares **Redaktuesi i shkurtoreve të procedurave**.

⚠ Butonat e shpejtë për ndryshimin e departamentit dhe hapja e dritares GDK

Qasja në procedurën për ndryshimin e departamentit të bibliotekës në COBISS Lib është e rregulluar në formën e butonit në shiritin e titullit të dritares së aplikacionit, ndërsa metoda **Materiali i bibliotekës kryesore** është zëvendësuar me metodën **Kartela**. Për këtë arsye, për këto dy procedura në COBISS Lib nuk mundësohet përcaktimi i butonave të shpejtë. Nëse butonat e shpejtë për këto dy procedura i keni përcaktuar në COBISS3, në COBISS Lib do të largohen pas ruajtjes së shkurtoreve të përcaktuara.

5 Këshilla për përdorimin e COBISS Lib

HAPËSIRA E PUNËS	KËSHILLA
Rregullimi i madhësisë së paraqitjes në ndërfaqe	Madhësinë e paraqitjes e redaktoni përmes funksionit Zmadho apo Zoom në shfletues.
Fshehja e emrave të moduleve	Nëse klikoni në ikonën  mund të fshehni ose t'i shfaqni modulet. Me këtë rritet hapësira e punës.
Shfaqja e hapësirës me dritare të hapura për kërkim ~ hapësira e punës	Në COBISS Lib hapësira e punës është zëvendësuar me funksionet e dritareve për kërkim. Regjistrimet, me të cilat ekzekutoni aksionet, ngarkohen në pjesën ku shfaqen rezultatet e kërkimit. Me këtë rast hapen aq dritare për kërkim sa janë grupet e përbajtjes, me të cilat ekzekutoni aksionet në COBISS Lib. Kjo do të thotë, se regjistrimet me të cilat punoni janë të grumbulluara në dritaret e veçanta për kërkim. Këto dritare hapen duke klikuar në ikonën  .
Rregullimi i butonave për procedurat e veçanta	Për disa nga funksionet që ekzekutohen më së shpeshti në modulën Parametrat dhe administrimi në grupin e përbajtjes 6 Parametrat , përmes procedurës Përcakto shkurtoret për procedurat përcaktoni butonat, të cilët vendosen nën shiritin e titullit COBISS Lib. Butonat shfaqen në të gjitha modulet.
Përzgjedhja e regjistrimeve në dritaren për kërkim, kontrollues	Fillimisht shtypni dhe mbani të shtypur tastin <Ctrl> , më pas klikoni në numrin rendor (jashtë kutisë së zgjedhjes) të regjistrimit të parë që dëshironi të filloni përzgjedhjen; pastaj shtypni dhe mbani të shtypur tastin <Shift> dhe klikoni numrin rendor të regjistrimit të fundit, që dëshironi të përzgjidhni.
Regjistrimet në lidhshmëri	Regjistrimet në lidhshmëri (p.sh. në dritaren për kërkim) i kontrolloni duke klikuar në butonin  , i cili hap kontrolluesin e regjistrimit të përzgjedhur. Në pjesën e poshtme të dritares shfaqen regjistrimet në lidhshmëri, të cilat mund t'i kontrolloni, t'i ngarkoni, t'i ruani midis regjistrimeve të parapëlqyera ose t'i shtoni tek historia.
Shkarkimi i regjistrimeve	Për nevojat e redaktimit të një numri të kufizuar të të dhënave, gjatë shkarkimit të regjistrimit në mënyrë automatike hapet aplikacioni COBISS Cat (në një skedë të re të shfletuesit), ku ofrohet mundësia Redaktimi i një numri të kufizuar të të dhënave bibliografike . Të dhënat redaktohen dhe ruhen, më pas skeda e shfletuesit të internetit mbyllet, sepse për çdo shkarkim të regjistrimit hapet COBISS Cat në një skedë të re të shfletuesit të internetit. Për qasje më të shpejtë në mundësinë për shkarkimin e regjistrimeve, në dritaren për kërkim Materiali ndodhet butoni Shkarko regjistrimin , i cili mundëson ekzekutimin e kësaj procedure.
Materiali i bibliotekës kryesore	Procedura Anëtarit / Materiali i bibliotekës kryesore , e cila ndodhet në COBISS3, në COBISS Lib është zëvendësuar me procedurën Kartela .
Katalogu në huazim	Në COBISS Lib është zëvendësuar me Fondi për huazim . Kjo mundësi ndodhet në dritaren Kartela , ku është në dispozicion edhe butoni Katalogu , i cili hap katalogun e bibliotekës në COBISS+. Procedura Katalogu , e cila është në dispozicion në grupin e përbajtjes Materiali , gjithashtu hap katalogun e bibliotekës në COBISS+.
Moduli Parametrat dhe administrimi	Në këtë modul janë në dispozicion funksionet e modulit COBISS3/Administrimi i aplikacioneve dhe funksionet, të cilat në COBISS3 ndodhen tek Sistemi .
Eksporti i të dhënave	Funksioni Eksporti i të dhënave ndodhet në modulën Raportet në skedën Eksporti i të dhënave . Skedarët e eksportuar në COBISS Lib i hapni përmes mundësisë Skedarët me të dhënat e eksportuara , e cila është në dispozicion në këtë skedë. Skedarët ruhen vetëm 7 ditë nga data e krijimit. Pas 7 ditësh skedarët fshihen.
Skedarët me të dhënat e eksportuara	Tek mundësia Skedarët me të dhënat e eksportuara , e cila ndodhet në skedën Eksporti i të dhënave , janë të disponueshme edhe skedarët me raportet e përgatitura, në formatin PDF. Skedarët ruhen vetëm 7 ditë nga data e krijimit. Pas 7 ditësh skedarët fshihen.
Inventari	Në COBISS Lib huazimi i inventarit bëhet nga dritarja Kartela e anëtarit të përzgjedhur, duke klikuar në butonin Inventari , në pjesën e djathtë të dritares tek të dhënat për anëtarin. Të dhënat për inventarin ndodhen në dritaren Kartela në skedën Inventari .
Problemet gjatë printimit	Në rast se keni probleme me printimin (p.sh. etiketa ose evidenca e huazimit nuk printohet) duhet të verifikoni: - destinacionet logjike (modulën Parametrat dhe administrimi / grupin 6 - Parametrat / Destinacionet logjike) - nëse printeri është i lidhur lokal apo në rrjet (kontrolloni tek administratori i pajisjeve tuaja) - nëse për printimin në printerin në rrjet duhet të keni emër të veçantë të përdoruesit (kontrolloni tek administratori i pajisjeve tuaja) - funksionimin e shërbimit COBISS DGW (moduli Parametrat dhe administrimi / grupi 9 - Serverët / Testo lidhjen me COBISS DGW)

 **Përdorimi i tasteve Prapa dhe Përsëri ngarko faqen (Reload, F5) në shfletues gjatë punës në COBISS Lib**

Tastet **Prapa** dhe **Përsëri ngarko faqen** ngarkojnë përsëri aplikacionin COBISS Lib dhe ju kthejnë në panelin e kontrollit, ndërsa të gjitha ndryshimet që nuk janë ruajtur humbin. Për këtë arsye përdorimi i këtyre dy mundësive nuk rekomandohet. Gjithashtu duhet të keni kujdes që COBISS Lib të mos e hapni në më shumë se një skedë në shfletues.

6 Fillimi i punës në COBISS Lib

Funksionet në program mund t'i ekzekutoni edhe në COBISS3 edhe në ndërfaqen COBISS Lib. Kjo do të thotë, se ndryshimet e bëra në COBISS3 do të transmetohen menjëherë edhe në COBISS Lib dhe anasjelltas (p.sh. përditësimi i të dhënave për koleksionet, ndryshimet në evidencën e materialeve të anëtarit etj.). Gjatë punës në COBISS Lib do të respektohen edhe parametrat, të cilët janë vendosur në bibliotekën tuaj në COBISS3.

Procedura e ekzekutimit të funksioneve në COBISS Lib është shumë e ngjashme me atë në COBISS3, vetëm [ndërfaqja](#) është ndryshe. Kjo do të thotë, se edhe më tutje mund të përdorni [dokumentacionin e përdoruesit](#), i cili është përgatitur për COBISS3. Dritaret e reja (siç është p.sh. dritarja **Materiali i bibliotekës kryesore**, e cila në COBISS Lib është zëvendësuar nga dritarja **Kartela**), janë përshkruar shkurt në kapitullin [Dritaret e projektuara në mënyrë të veçantë](#).

Kalimi nga COBISS3 në COBISS Lib nuk kërkon procedura të veçanta, siç ka ndodhur me kalimin nga COBISS2 në COBISS3, dhe nuk janë të nevojshme këto procedura:

- krijimi i mjedisit testues dhe transferimi i të dhënave
- kontrolli i saktësisë së të dhënave të transferuara
- konfirmimi i saktësisë së të dhënave të transferuara
- përcaktimi i datës së implementimit etj.

Kjo do të thotë, se aplikacionin COBISS Lib mund të filloni ta përdorni menjëherë pas instalimit. Vendosi vet, se me cilat funksione do të filloni përdorimin e aplikacionit COBISS Lib dhe cilat funksione do të filloni t'i përdorni më vonë. Ju rekomandojmë, që të filloni sa më shpejt me ekzekutimin e procedurave në COBISS Lib.

COBISS3 dhe COBISS Lib mund t'i përdorni njëherësh edhe për një kohë.

Në rast të ndonjë mangësie ose gabimi, ju lutem na shkruani në adresën elektronike sherbimi@al.cobiss.net për bibliotekat në Shqipëri apo në sherbimi@ks.cobiss.net për bibliotekat në Kosovë. List e funksioneve kryesore që COBISS Lib ende nuk i mbështet ndodhet në kapitullin [Lista e funksioneve që nuk mbështet COBISS Lib](#). Këto procedura edhe më tutje duhet t'i ekzekutoni në COBISS3.

7 Lista e funksioneve që nuk mbështet COBISS Lib

Në vazhdim janë paraqitur funksionet kryesore, të cilat COBISS Lib V13.0 ende nuk i mbështet. Lista përditësohet në vazhdimësi, sepse punohet në mënyrë intenzive në zhvillimin e funksioneve. Këto procedura edhe më tutje i ekzekutoni në COBISS3:

- **COBISS Lib – të përgjithshme:**
 - bibliografite
 - ende nuk janë të gjitha dritaret në COBISS Lib të përshtatshme për përdorim në pajisjet mobile (p.sh. dritarja Kartela)
- **Huazimi:**
 - mundësia e përdorimit të integruar të terminalit POS dhe pagesës VALÚ
 - përdorimi i kartelës URBANA
 - në dritaren *Fondi për huazim* ende nuk janë të rregulluara në tërësi procedurat dhe formatet e shfaqjes së të dhënave për kompletet, serialet dhe të dhënave të tjera, që janë në dispozicion në COBISS3
- **Koleksionet e bibliotekës:**
 - mbështetja e përpunimit të materialeve me RFID (inventarizimi me zgjidhjet e IZUM-it)
- **Huazimi ndërbibliotekar, Pasurimi, Serialet:**
 - tek shënimi i të dhënave për materialin nuk mundësohet transferimi i të dhënave për materialin nga bazat e tjera (të huaja) të të dhënave
- **Raportet:**
 - klasifikimi

COBISS Cat

COBISS Cat është aplikacion i veçantë. Më shumë rreth këtij aplikacioni mund të shikoni në materialin [prezantimi i aplikacionit në konferencën COBISS](#) dhe mund të lexoni në [Udhëzime për përdorimin e COBISS Cat](#).